

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT:

DPS/KT 248 “Tekstile dhe prodhime tekstili”

A Historiku

DPS/KT 248 është krijuar në 15.05.2006, në përputhje me Ligjin Nr.9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje me tekstilet të cilat një nga mallrat më të rëndësishëm në ekonominë globale. Brenda fushëveprimit të këtij KT industritë tekstile përfshijnë sigurimin e lëndëve të para, përgatitjen e prodhimit të fibrave dhe fijeve, prodhimin e dizenjimit të veshjeve, lëndët e fundit duke përfshirë këtu zbardhuesit dhe ngjyrosjen. Gjithashtu një rëndësi e veçantë në këtë KT i kushtohet veshjeve, trajtimeve kimike, transformimit të veshjeve në tapiceri, veshjeve apo tekstileve industriale /teknike në tyle dhe në perde .

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme

Puna e DPS/KT 248 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të politikave ekonomike, teknike, rregullave ligjore të cilat janë të përfshira në praktikat të cilat lidhen ngushtë me objektivat e këtij KT. Tradicionalisht industria e tekstitit dhe e veshjeve janë të mbrojtura mirë. Industria e tekstitit dhe e veshjeve është një burim shumë i rëndësishëm të ardhurash dhe punësimi në shume vende, në veçanti për vendet që kërkojnë zhvillim të industrisë së kësaj fushe duke u bazuar në ekonominë e vendit .

B.2 Treguesit sasiorë të mjedisit të biznesit

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga KT 248 përfshijnë një shumëllojshmëri të subjekteve të tilla si furnizuesit e lëndëve të para, përpunuesit, tregtarët, prodhuesit, shpërndarësit, shitësit, industritë e lidhura me këte fushë, konsumatorët, organizmat e çertifikimit, organizmat qeveritare, institucionet arsimore, kompani të ndryshme dhe autoritetet kombëtare të inspektimit.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë

- përmirësimin e cilësisë së produktit;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;
- ndihmën në globalizimin e ekonomisë të bazuar në konkurrencë;
- zhvillimin e industrisë së tekstileve në vendet e zhvilluara duke u bazuar në ekonomi.

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 2/3

C Përfitimet

Puna e DPS/KT 248 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- zhvillimin e industrisë së tekstilit, që kryesisht kanë të bëjnë me specifikimet e metodave të provës të cilat ofrojnë mjete për të mundësuar vlerësimin objektiv të procesit;
- lehtësimin e lidhjes midis prodhuesve, konsumatorëve dhe organeve përgjegjëse për inspektimin dhe testimin teknik;
- mbështetjen për legjislacionin evropian;
- kërkesat e sakta për këtë industri në aspektin e cilësisë, menaxhimit të mjedisit si dhe në mbrojtjen e konsumatorit

D Pjesëmarrja në DPS/KT 248

Në DPS/KT 248 ka përfaqësues nga subjekte private, Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial i cili është organizmi i inspektimit, i cili merret direkt me kontrollin e tregut, vlerësimin e konformitetit të industrisë së tekstilëve dhe veshjeve. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

E Objektivat dhe strategjitë


E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/KT 248

- Miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për zhvillimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare për kërkesat e performancës, metodat e provës së tekstilëve dhe produkteve të tekstilëve për industrinë e tekstilëve dhe e konsumatorëve që mbulohen nga ky KT duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;
- Rregullimi i programit ekzistues të punës për të qenë relevant me nevojat e deklaruara të industrive dhe të konsumatorëve;
- Qasja e projekteve të bazuara në zhvillimin e standardeve të kësaj industrie.

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 248 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 189	Gjeosintetika
CEN/TC 248	Tekstile dhe prodhime tekstili
ISO/TC 38	Tekstile
CEN/TC 443	Pupël dhe push
ISO/TC 133	Sistemet e përmasave të veshjes, përcaktimi i përmasave, metodat e matjes së përmasave dhe pajisjet dixhitale

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/3	

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të më sipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

Sekretari i DPS/KT 248

(Elona TELULI)